



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

Për:	Anëtarët e OFK-së Anëtarët e Kuvendit Anëtarët e organeve të OFK-së
Nga:	Arianit Jakupi – Kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës
Tema:	Qarkore informative për veprimtarinë e OFK-së gjatë zbatimit të masave mbrojtëse
Datë:	15 Mars 2020

Të nderuar anëtarë,

Në kuadër të masave parandaluese në funksion të mbrojtjes nga Coronavirus Qeveria e Kosovës me datë 13.03.2020 ka nxjerrë Vendimin nr. 01/09, me të cilin janë përcaktuar masat mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik Sars-CoV-2.

Prandaj, në zbatim të këtij vendimi me anë të kësaj qarkore informative ju njoftojmë për funksionimin e zyrës së OFK-së deri në njoftimin e radhës.

Duke filluar nga dita e hënë 16 Mars 2020:

- Puna me palë në zyrat e OFK-së do të pezullohet në kohë të pacaktuar, rrjedhimisht zyrat e OFK-së do të jenë të mbyllura gjatë kësaj periudhe.
- Shërbimet për anëtarët do të ofrohen në mënyrë elektronike nëpërmjet emailit: info@ofk-rks.net.
- Varësisht shërbimit të kërkuar, anëtari i dërgon dokumentet e kërkuara në mënyrë të skanuar.

- Shërbimi i kërkuar të njëjtit do ti dërgohet në email adresë në rast se është e mundëshme të ofrohet.
- Dokumentet origjinal nga ana e anëtarit do të dorëzohen pas fillimit të punës me palë, me ç'rast palët do të tërheqin origjinalin e dokumentit për shërbimin e kërkuar.
- Organet e OFK-së do të mbajnë takime vetëm në rast urgjence, sipas formës dhe dakordimit me Kryetarin dhe Shërbimin Profesional të OFK-së

OFK kërkon mirëkuptimin e anëtarëve të sajë për këtë situatë dhe inkurajon që shërbimet të kërkohen vetëm për raste me urgjencë.

OFK do të jetë në vazhdimësi në përcjellje të situatës dhe në dispozicion për dhënie të ekspertizës profesionale dhe në mbrojtje të interesave profesionale të anëtarëve të saj pranë instucioneve.

Për çfardo sqarimi shtesë na shkruani në emailin info@ofk-rks.net, ose në nr. e telefonit 044886723

Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi

